

SYLLABUS

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike	Fakulteti i Menaxhmentit		
Programi	Menaxhim i Biznesit dhe Ndërmarrësia		
Titulli i lëndës	Sjellja Organizative		
Niveli	Baçelor		
Statusi i lëndës	Obligative		
Viti i studimeve	II		
Semestri	IV		
Numri orëve në javë	3		
Vlera në kredi - ECTS	5		
Koha / lokacioni	UShAF		
Mësimdhënësi i lëndës			
Detajet kontaktuese			
Përshkrimi i lëndës	Temat kryesore që mbulojnë këtë modul janë si vijon: Hyrje në sjelljen organizative; Modeli i përgjithshëm i sjelljes në punë: Vlerat dhe qëndrimet; Personaliteti; Perceptimi; Shkathësitë dhe aftësitë; Motivimi përmes dizajnit të punës; Sjellja në grup; Marrëdhëniet shoqërore nga dhe në Organizatë; Komunikimi; Fuqia dhe sjellja politike.		
Qëllimet e lëndës	Studentët njihen me kuptimin e sjelljes organizative dhe mësojnë se si të kuptojnë sjelljen e punonjësve dhe si të arrijnë efektivitet më të madh me përdorimin e burimeve njerëzore, si të motivojnë dhe vlerësojnë punëtorët në mënyrë që të stimulojnë performancën e rritur të punonjësve në punë.		
Rezultatet e pritura të mësimnxënies	Pas mbarimit të modulit studenti do të jetë në gjendje të: 1. identifikojë dhe shpjegojë rolin e personalitetit dhe të sjelljes që ndikojnë në perceptimin organizativ. (ECTS: 1) 2. krahasojë qasjet që lidhen me motivimin e punonjësve dhe të performancës. (ECTS: 1) 3. kuptojë rëndësinë e komunikimit efektiv brenda organizatës, të diskutoj rëndësinë e grupeve në organizata dhe se si ata mund të ndikojnë në vendim-marrje, efikasitetin dhe efektshmërinë e organizatës. (ECTS: 1) 4. vlerësoj rolin dhe efektivitetin e lidershipit brenda organizatës dhe të zbatoi etikën në vendin e punës. (ECTS: 1)		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrimet teorike/detyra	1	15	15
Punë praktike	5	1	5
Kontaktet me mësimdhënësit – konsultimet	1	5	5
Ushtrime në terren			
Kollokuium – seminare	2	2	4

Detyra të shtëpisë	2	4	8
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			38
Përgatitja përfundimtare në provim	3	2	6
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	2	2	4
Projektet, prezantimet etj	1	5	10
Totali			125

Metodologjia e mësimeve (dhe mësuesit)	Ligjërata interaktive me studentë, duke marrë rastet studimi të cilat do të diskutohen në grup, mësuesi duke u bazuar në një problem/shans të paraqitur, luajtja e roleve, mësime praktike për lëndën dhe angazhim për studentin për të prezantuar njohurit e fituara përmes rasteve studimore, punimeve seminarike, apo/ dhe hulumtimeve, zgjidhjes së detyrave numerike dhe interpretimit të tyre.
Metodat e vlerësimit (kriteret e kalueshmërisë)	Metoda e vlerësimit – mbështetet në tri aktivitete – në bazë të të cilave do të ndërtohet nota përfundimtare: • Aktivitet dhe Angazhim në mësim.....max 20 pikë (20%), • Hartimi / prezantimi i punimi seminarik.....max 10 pikë (10%), • Provimi final (ose nga dy teste).....max 70 pikë (70%), Kriteret e kalueshmërisë - ndërlidhur me aktivitetet e parapara me metodën e vlerësimit: 1. Aktiviteti dhe Angazhimi në mësim – vlerësohet me 20 pikë (20%) nga 100 pikë (100%) të mundshme: • Aktiviteti në mësim (10 pikë (10%)) - nënkupton që studenti të jetë aktiv dhe i përfshirë në diskutime interaktive profesor-studentë, student-student, duke hapur tema të reja që janë të ndërlidhura me lëndën, duke dhënë ide, opinione, mendime kritike me qëllim të nxitjes së debatit gjatë ligjëratave. • Angazhimi (10 pikë (10%)) - nënkupton që studenti t'i kryej dhe prezantoj detyrat që caktohen në fund të secilës ligjërata dhe pastaj diskutohen në fillim të ligjëratës vijuese. Qëllimi: Nxitja e mendimit kritik dhe zgjidhja kreative e situatave reale të ndërlidhura me problemet e parashtruara - të ndërlidhura me mësim-nxënien në modulën e lëndës. 1. Hartimi dhe prezantimi i një punimi seminarik - vlerësohet me 10 pikë (10%) nga 100 pikë (100%) të mundshme. Brenda semestrit studenti duhet të përgatit një punim seminari (Word dhe në PowerPoint), i cili duhet të prezantohet gjatë orëve të caktuara për prezantim. Prezantimi do të zgjasë më së shumti 15 minuta. Tema e punimit mund të propozohet nga profesori dhe nga studenti – tema e propozuar nga studenti duhet të miratohet nga profesori, dhe e njëjta duhet të jetë në korrelacion të plotë me lëndën. Punimi prezantohet para grupit dhe vlerësohet në bazë të cilësisë së përmbajtjes, analizës, kreativitetit dhe aftësisë për ta prezantuar qartë.

Kriteret e vlerësimit të projektit/punimit seminarik	
Komponenti	Pikët (%)

Struktura dhe Qëllimi i punimit	2
Përmbajtja/shtjellimi i punimit	2
Përfundimet e nxjerra dhe prezantimi i punimit	2
Kreativiteti i shprehur në punim / prezentim	2
Aftësisë për prezentim	2
Gjithsej:	10

Qëllimi: zhvillimi i aftësive kërkimore, analitike dhe shkencore, përmes trajtimit të një teme të caktuar në mënyrë të pavarur dhe akademike - të ndërlidhura me mësim-nxënien në modulin e lëndës.

2. Testi i provimit final, vlerësohet me 70 pikë (70%) nga 100 pikë (100%) të mundshme,

Brenda semestrit parashihet të mbahen dy Teste (2 x 35 pikë (35%)) për studentët e angazhuar aktiv me pjesëmarrje në ligjërata. Testi i parë në javën e 7 (shtatë) ose të 8 (tetë) dhe testi i dytë në fund të ligjëratave, studenti e kalon testin nëse ka min 18 pikë (18%), pasi që studenti vlerësohet se ka kaluar testin e parë, atëherë studenti mund t'i nënshtrohet testit të dytë. Studenti ka të drejtë të nënshtrohet drejtpërdrejt provimit final - me gojë ose me shkrim. Studenti do t'i nënshtrohet testit të provimit final, pas përfundimit të ligjëratave të lëndës dhe në afatet e provimeve të përcaktuara nga Senati i Universitetit.

Qëllimi i provimit është që të vlerësohet njohuria, aftësia, shkathtësia dhe kompetencat e studentit, ndërlidhur me rezultatet e mësim-nxënies të parapara në materialin e lëndës së ligjëruar.

Testi i provimit (formulari me pyetje) duhet të plotësohet në mënyrë individuale nga studentit dhe i njëjti vlerësohet sipas kriterëve dhe përmban:

- ♦ pyetje objektive me zgjedhje të shumëfishta alternative, të cilat do të shfrytëzohen për të vlerësuar aftësitë e studentit për të rikujtuar dhe njohur konceptet dhe materialin e lëndës.....**30 pikë (30%),**
- ♦ pyetje subjektive të llojit tema për shpjegim/përgjigje me shkrim/detyra - për të cilat vet studentit duhet të jetë në gjendje të jep përgjigje ndërlidhur me materialin e lëndës së ligjëruar, të cilat përgjigje do të shfrytëzohen për të vlerësuar të kuptuarit dhe aftësitë e studentit për të zbatuar njohuritë e fituara në analizë, sintezë/vlerësim të problemit....**40 pikë (%)**

Qëllimi i testit: të vlerësojë përvetësimin e rezultateve të mësim-nxënies dhe aftësinë për t'i zbatuar ato në situata praktike.

Studenti e kalon provimin nëse grumbullon 50 pikë (%) nga të gjitha aktivitetet e parapara me metodën e vlerësimit,

Notat në UShAF:

Nota	ECTS/Nota	Përqindja (%)	Përkufizimi
10	A	90 - 100	Shkëlqyeshëm
9	B	80 - 89	Shkëlqyeshëm
8	C	70 - 79	Shumë mirë
7	D	60 - 69	Mirë
6	E	50 - 59	Mjaftueshëm
5	FX/F	0 - 49	Pamjaftueshëm

Mjetet e konkretizimit – TI	Laptopi, projektori, tabela-smart, wireless, interneti, MS Teams, instrumente testimi të aftësive, etj..
Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit	70% - Teori, 30% - Ushtrime/detyra praktike, Ky raport ka për qëllim të analizojë lidhjen ndërmjet njohurive teorike të përfituara gjatë ligjëratave të parapara në modulën e lëndës dhe realizimit të ushtrimeve praktike (vizita praktike, ushtrime me studentë, kuize studentore në klase, etj.). Nga gjithsej 125 orë të parapara për lëndën, ndarja është bërë sipas raportit 70% me fokus në teori dhe 30% në ushtrime/detyra praktike. • 87,5 orë janë të dedikuara për ligjërata teorike, përfshirë përvetësimin e koncepteve bazë, metodologjive dhe standardeve të parapara në modulën e lëndës. • 37,5 orë janë të fokusuar në ushtrime/detyra praktike, analiza rastesh konkrete, punë në grup dhe zhvillim projektsh simulimi. Ndarja e 6 ECTS sipas raportit 70%-30% ❖ 3,5 ECTS - i dedikohen pjesës teorike, ❖ 1,5 ECTS - i dedikohen pjesës ushtrime/detyra praktike, Kjo ndarje reflekton balancën ndërmjet përvetësimit të koncepteve bazë dhe zbatimit të tyre përmes aktiviteteve praktike.
Literatura	
Literatura bazë	1. Bislim Lekiqi, (2025), Sjellja Organizative, Ligjërata të autorizuara në formë tekstuale dhe në formë të video incizimeve, USHAF 2. BISLIM LEKIQI, 2022, Human resource planning in manufacturing enterprises, Technium Social Sciences Journal (ISSN: 2668-7798) 3. Canco G., etj., (2016), Siellja Organizative, Tiranë;
Literatura shtesë	1. Stephen Robbins, Timothy Judge, (2021) Organizational Behavior; Updated 18e, Global Edition
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë	Prezantimi – njoftimi i studenteve me syllabusin e lëndës, • Njoftimi me studentët • Studentëve do të ju prezantohet syllabusi në detaje Rezultati i prituri nr. 1, 2, 3, 4
Java e dytë	Hyrje në Sjelljen Organizative – do të trajtohen nëntemat: • SO dhe disiplinat e tjera shumë të afërta • Metodatat e studimit të SO • Vlerësimi i rezultateve të kërkimeve Rezultati i prituri nr. 1, 2, 3, 4
Java e tretë	Një model i përgjithshëm i studimit të sjelljes në punë – do të trajtohen nëntemat: • Njohuri për individin • Faktorë të tjerë që ndikojnë në sjelljen e individit në organizatë • Karakteristikat biografike Rezultati i prituri nr. 2
Java e katërt	Vlerat dhe qëndrimet – do të trajtohen nëntemat: – do të trajtohen nëntemat:

	• Karakteristikat e vlerave • Rëndësia e vlerave për SO • Hierarkia e vlerave • Njerëzit përpiqen të zvogëlojnë mospërputhjen • Ndryshimi i qëndrimeve • Shkaqet e qëndrimeve në punë • Funksionet e qëndrimeve • Qëndrimet në punë • Përkushtimi ndaj organizatës • Përfshirja në një punë Rezultati i prituri nr. 1, 3
Java e pestë	Personaliteti– do të trajtohen nëntemat: • Faktorët që ndikojnë në formimin e personalitetit • Tipologjia e Jungut • Përshtatja e personalitetit me punën • Cilësi të personalitetit që i interesojnë SO • Pika e kontrollit • Nevoja për të qenë rezultativ • Vetëvlerësimi • Vetë efikasiteti • Kujdesi për të kënaqur anën «e duhur» të vetes • Vlerat e personalitetit si parashikues i sjelljes në punë Rezultati i prituri nr. 1, 2, 3, 4
Java e gjashtë	Perceptimi – do të trajtohen nëntemat: • Faktorët e jashtëm (që lidhen me objektin që perceptohet) • Faktorët e brendshëm (që lidhen me perceptuesin) • Organizimi i perceptimit • Perceptimi i personave • Menaxhimi i përshtypjes • Teoria e atribuimit • Shkurtime (gabime) në gjykimin e të tjerëve Rezultati i prituri nr. 2
Java e shtatë	Kollokiumi 1 - Vlerësimi i parë intermedier Për vlerësim do të jenë temat e trajtuara para kollokiumit të parë Rezultati i prituri nr. 1, 2, 3, 4
Java e tetë	Sjellja në kontestin ndërkombëtar– do të trajtohen nëntemat: • Faktorët e kulturës kombëtare që ndikojnë mbi kulturën organizative dhe sjelljen e individit • Modeli Kluckhohn – Strodtbeck • Modeli HOFSTED • Modeli i BOND • Projekti GLOBE Rezultati i prituri nr. 1, 2, 3, 4
Java e nëntë	Aftësitë dhe mjeshtëritë– do të trajtohen nëntemat: • Aftësitë intelektuale • Inteligjenca Emocionale • IQ apo IE • Aftësitë fizike • Aftësitë e menaxherit • Modeli Katz Rezultati i prituri nr. 1, 2
Java e dhjetë	Motivimi nëpërmjet projektimit të punëve– do të trajtohen nëntemat:

	• Kuptimi i «të ardhurave» • Të ardhurat që varen / nuk varen nga kryerja e punës • Të ardhurat e brendshme dhe të jashtme • Tri metoda të ndryshme motivimi, një qëllim: Motivimi përmes objektivave (MO), Pasurimi i punës dhe Përforsimi pozitiv Rezultati i prituri nr. 2
Java e njëmbëdhjetë	Sjellja në grup – do të trajtohen nëntemat: • Kuptimi i «të ardhurave» • Të ardhurat që varen / nuk varen nga kryerja e punës • Të ardhurat e brendshme dhe të jashtme • Tri metoda të ndryshme motivimi, një qëllim: Motivimi përmes objektivave (MO), Pasurimi i punës dhe Përforsimi pozitiv Rezultati i prituri nr. 1
Java e dymbëdhjetë	Komunikimi – do të trajtohen nëntemat: • Mënyra e komunikimit ndërpersonal • Dallimi gjinor në komunikim • Modelet e komunikimit në organizatë • Rrjetat e komunikimit • Dëgjimi aktiv • Zhvillimi i aftësive për të dëgjuar në mënyrë aktive • Fidebku Rezultati i prituri nr. 3
Java e trembëdhjetë	Pushteti dhe sjellja politike – do të trajtohen nëntemat: • Thelbi i pushtetit • Tiparet e pushtetit • Bazat dhe burimet e pushtetit • Koncepti i varësisë • Karakteristikat e subjektit që influencohet • Pushteti në grup – koalicionet • Distanca e pushtetit • Sjellja politike • Burimet e sjelljes politike Rezultati i prituri nr. 4
Java e katërmëdhjetë	Kollokfiumi 2 - Vlerësimi i dytë intermedier Për vlerësim do të jenë temat e trajtuara pas kollokfiumit të parë Rezultati i prituri nr. 1, 2, 3, 4
Java e pesëmbëdhjetë	Prezentimi i punimeve seminarike Studentët do të prezentojnë punimet e tyre. Rezultati i prituri nr. 1,2,3,4
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes	
Studenti është i obliguar t'i vijojë ligjëratat më rregull dhe të ketë sjellje korrekte ndaj kolegëve dhe stafit të Universitetit, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në ligjëratat dhe ushtrime është e obligueshme. Gjatë orëve të ligjëratave dhe ushtrimeve NDALOHET ushqimi, pëshpërimat që pengon punën në klasë dhe përdorimi i telefonave mobil. Njëkohësisht, telefonat celularë duhet të fiken ose të vihen në heshtje dhe të mos përdoren gjatë kohës së ligjëratave apo ushtrimeve. Mungesa e integritetit akademik (ku përfshihet plagjiatura, kopjimi i punës së një personi tjetër, përdorimi i ndihmave të paautorizuara në provime, mashtrimi etj.) nuk do të tolerohet. Nëse ka dyshime për vërtetësinë e punës së paraqitur, mësuesi ka të drejtë t'i kërkojë studentit të verifikojë punën e tij/saj. Kjo mund të bëhet përmes: përsëritjes së punës, testimit me shkrim ose me gojë, kuiz i papritur apo me çdo veprim tjetër që konsiderohet i nevojshëm nga ligjëruesi.	